



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
STRUKTURA E POSAÇME KUNDER KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TE  
ORGANIZUAR  
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR



**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT**  
**viti 2022**

*Shkurt 2023*

## Tabela e Përmbajtjes

<b>Kuadri Ligjor Rregullator.....</b>	<b>3</b>
<b><i>HYRJE.....</i></b>	<b>4</b>
<b><i>1. Qëllimi dhe objektivat e programit.....</i></b>	<b>5</b>
<b><i>2. Analiza e shpenzimeve faktike të programit.....</i></b>	<b>7</b>
<b><i>3. Analiza sipas llogarive ekonomike për vitin 2022</i></b> <b><i>.....</i></b>	<b>10</b>
<b>3.1 Shpenzimet e personelit .....</b>	<b>11</b>
<b>3.2 Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera .....</b>	<b>12</b>
<b>3.3 Transferta për buxhete familjare.....</b>	<b>13</b>
<b>3.4 Shpenzime për Investime Kapitale .....</b>	<b>14</b>
<b>3.5 Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit .....</b>	<b>14</b>
<b>3.6 Dretyrimet e prapambetura.....</b>	<b>15</b>

## KUADRI LIGJOR RREGULLATOR

1. LIGJI 95/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”, I NDRYSHUAR.
2. LIGJI 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTAREVE DHE PROKUROREVE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”
3. LIGJI NR. 9936, DATE 26.06.2008 “PËR MENAXHIMIN E SISTEMIT BUXHETOR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE”, I NDRYSHUAR.
4. LIGJI 10296, DATE 08.07.2010 “PËR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN” (I NDRYSHUAR),
5. LIGJI NR.115/2021 “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”,
6. UDHËZIMIT NR. 1, DATE 10.01.2022 “PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2022”,
7. LIGJI NR.162/2020 “PËR PROKURIMET PUBLIKE”,
8. VKM 285/2021”PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK I NDRYSHUAR”
9. AKTIT NORMATIV NR. 3, DATE 12.03.2022, “PËR DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 115, DATE 25.11.2021;
10. AKTIT NORMATIV NR. 12, DATE 29.07.2022 “PËR DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 115, DATE 25.11.2021”
11. AKTIT NORMATIV NR. 17, DATE 01.12.2022 “PËR DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 115, DATE 25.11.2021”
12. UDHËZIMI I MINISTRIT TË FINANCEVE DHE EKONOMISE NR.9, DATE 20.03.2018 “PËR PROCEDURAT STANDARTE TË ZBATIMIT TË BUXHETIT”
13. UDHËZIMIT NR.22, DATE 17.11.2016 “PËR PROCEDURAT STANDARTE TË MONITORIMIT TË BUXHETIT PËR NJESITE E QEVERISJES QENDRORE”

## HYRJE

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2022 për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e SPAK-ut, (Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Byroja Kombëtare e Hetimit) kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin strategjik të ecurisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut në krahasim me planin e miratuar, të detajuar në nivel treguesi performance. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Me qëllim për të kontribuar në proceset bazë të misionit dhe objektivave të institucionit buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, do të mbështetet plotësisht në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu dhe monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ato tregues të planifikuar gjatë hartimit të programit buxhetor afatmesëm.

Ky raport zyrtar do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës SPAK do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë së institucionit.

## 1. Qëllimi dhe objektivat e programit

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtaria e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar gjatë procesit të PBA 2022-2024 dhe është në funksion të realizimit të Politikës së Programit mbështetur mbi treguesit e performancës së institucionit.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbështetur në Ligjin Nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” është një strukturë e specializuar për të ushtruar kompetencat e parashikuara në pikën 1, të nenit 148/dh, të Kushtetutës, për të hetuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe veprat e tjera penale të kryera vetëm nga subjektet e parashikuara në pikën 2, të nenit 135 të Kushtetutës dhe veprat penale sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurave Penale. Mbështetur mbi prioritetet strategjike të institucionit dhe misionit e vizionit është synuar përmbushja e detyrave kryesore gjatë vitit buxhetor 2022 në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Politika e këtij programi konsiston në hetimin e thelluar të rasteve që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar në Republikën e Shqipërisë, duke u përqendruar në çështjet me ndjeshmëri publike dhe arritjen e rezultateve në zbatimin e ligjit që do të përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve. Gjithashtu, në objektivat e institucionit qëndron përmirësimi i treguesve të respektimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës, përmes përmbushjes së standardeve evropiane të respektimit të ligjit. Një aspekt i rëndësishëm për konsolidimin e plotë është rritja e kapaciteteve të SPAK në vendosjen para ligjit të shkelësve përmes stafit të Prokurorëve të Posaçëm dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, por edhe forcimi institucional nëpërmjet rekrutimit cilësor të burimeve njerëzore e mirëmenaxhimit të burimeve financiare.

Hartimi i politikave afatgjata në funksion të arritjes së objektivave strategjike për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbështeten mbi disa nga qëllimet bazë të mëposhtme:

1. Ndjekja dhe zgjidhja e të gjitha rasteve hetimore lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar në Republikën e Shqipërisë.
2. Rritja e efektivitetit në procesin e hetimit dhe zgjidhjes së rasteve mbi pastrimin e produkteve të lidhura me krimin e organizuar dhe korrupsionin.
3. Forcimi i respektimit të ligjit në drejtim të sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve që rrjedhin nga aktivitetet kriminale.
4. Krijimi i një strukture profesionale hetimore si Byroja Kombëtare e Hetimit që do të japë rezultate nëpërmjet rritjes së efikasitetit të punës në çështjet hetimore për respektimin e ligjit në funksion të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.
5. Forcimi i kapaciteteve administrative, të afta për tu përgjigjur nevojave gjithmonë e në rritje për përmbushjen e misionit dhe vizionit të institucionit.

Menaxhimi Financiar i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është fokusuar në financimin e shpenzimeve për përmbushjen e objektivave prioritare strategjike të mëposhtme:

- *Përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të institucionit, duke rritur numrin e çështjeve hetimore në proporcion me problematikat e shkeljes së ligjit për rastet e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe duke rritur kapacitetin profesional të punonjësve nëpërmjet trajnimeve.*
- *Krijimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme për Prokurorët, Hetuesit e BKH dhe personelin administrativ, në funksion të arritjes së rezultateve pozitive në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit.*
- *Ofrimi i sigurisë maksimale fizike dhe financiare për personelin hetimor dhe administrativ të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si një garanci afatgjatë e integritetit Kushtetues të Institucionit.*

- Zgjerimin e kapaciteteve analizuese dhe përpunuese të informacionit, në funksion të rritjes së eficiencës dhe efektivitetit të ndjekjes së rasteve të problematikave objekt i ligjit dhe aktivitetit të SPAK.
- Përdorimin e teknologjisë më të avancuar në funksion të ekspertizës dhe hetimeve proaktive sipas kompetencës ligjore të Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.
- Paraqitjen e një produkti hetimor cilësor, që përkthehet në raste të suksesshme të përfunduara dhe të dërguara për gjykim pranë GJKOK.
- Përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të punës në shërbim të një trajtimi sa më efektiv të rasteve hetimore.
- Pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale si dhe të krijimin e kushteve të përshtatshme të punës për punonjësit.
- Mirëmenaxhimin e institucionit, duke aplikuar metodologjitë më të përparuara si në menaxhimin financiar ashtu edhe në trajtimin e burimeve njerëzore.

Mbulimi e prioriteteve strategjike të institucionit me fondet e mjaftueshme buxhetore, është një synim i cili do ti sigurojë institucionit pavarësinë, qëndrueshmërinë dhe integritetin e nevojshëm për arritjen e rezultateve që përmirësojnë jetën e qytetarëve.

## 2. Analiza e shpenzimeve faktike të programit viti 2022

Buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022 është miratuar me ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe në vijim është rishikuar me Aktin Normativ Nr. 3, datë 12.03.2022 si dhe Aktin Normativ Nr. 12 datë 29.07.2022, dhe Nr 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 115/2021“Për buxhetin e vitit 2022, i ndryshuar”, ku në total buxheti i rishikuar është 663.3 milion lekë.

**Tabela 1: Totali i shpenzimeve të programit për vitin 2022 (në mijë lekë)**

Titulli	Emertimi	1 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	2 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	3 Fakti Vjetor 2022	4=(2-3) Diferenca	% e realizimit plan fakt
---------	----------	--	--	---------------------------	----------------------	-----------------------------

03390	Veprimtaria e SPAK	1,038,800	663,300	588,063	75,237	89%
<b>Totali i Shpenzimeve te Institucionit</b>		<b>1,038,800</b>	<b>663,300</b>	<b>588,063</b>	<b>75,237</b>	<b>89%</b>
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limiti						
<b>Totali</b>		<b>1,038,800</b>	<b>663,300</b>	<b>588,063</b>	<b>75,237</b>	<b>89%</b>

*Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2022);*

Gjatë vitit 2022, këto burime financiare SPAK si një institucion kushtetues, i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligj.

Fondet buxhetore të miratuara përmes ligjit vjetor të buxhetit, SPAK i ka administruar për financimin e aktiviteteve në një program të përcaktuar me emertimin “Veprimtaria e SPAK”. Në këtë program është mbuluar efekti financiar për Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit për forcimin e kapaciteteve të domosdoshme hetimore.

Treguesit bazë të realizimit buxhetor për këtë program paraqiten si më poshtë:


**Tabela 2: Raporti i shpenzimeve të programit sipas llogarive ekonomike (në mijë lekë)**

Art.	Emertimi	2 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	3 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	4 Buxheti 2022	5 Fakti 12- mujor	6=(5-4) Diferenca	Perqindja e realizimit Plan/Fakt (%)
600	Paga	697,109.0	474,081.0	474,081.0	429,825.6	-44,255.4	91%
601	Sigurime Shoqërore	183,574.0	44,985.0	44,985.0	38,006.2	-6,978.8	84%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	128,117.0	121,305.0	121,305.0	99,042.2	-22,262.8	82%
603	Subvencione					0.0	
604	Transferta Korente të Brendshme					0.0	
605	Transferta Korente të Huaja					0.0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	329.0	1,928.9	1,928.9	1,838.9	-90.0	95%
<b>Nen- Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>1,009,129.0</b>	<b>642,299.9</b>	<b>642,299.9</b>	<b>568,712.9</b>	<b>-73,587.0</b>	<b>89%</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara					0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara	30,000.0	21,000.0	21,000.0	19,350.4	-1,649.6	92%
232	Transferta Kapitale					0.0	
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>30,000.0</b>	<b>21,000.0</b>	<b>21,000.0</b>	<b>19,350.4</b>	<b>-1,649.6</b>	<b>92%</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara					0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara					0.0	
232	Transferta Kapitale					0.0	
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>30,000.0</b>	<b>21,000.0</b>	<b>21,000.0</b>	<b>19,350.4</b>	<b>-1,649.6</b>	<b>92%</b>
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				0.0		0.0	
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)</b>		<b>1,039,129.0</b>	<b>663,299.9</b>	<b>663,299.9</b>	<b>588,063.3</b>	<b>-75,236.6</b>	<b>89%</b>

*Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2022);*

Pesha specifike sipas llogarive ekonomike të shpenzimeve të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve, paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:

**Grafiku 1: Pesha sipas llogarive ekonomike e planit të buxhetit 2022**



*Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2022);*

Duke u mbështetur në veprimtarinë bazë të instiucionit, pjesë përbërës e të cilit janë:

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041001,
2. Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) me kod institucioni në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë 1041002,

kjo shpërndarje e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës dhe kërkesat e SPAK për të përmbushur detyrimet ligjore.


Nga analiza e peshës së shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit të SPAK ashtu siç mund të konstatohet në grafikun më lart pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zënë llogaria “Paga” në rreth 71.45%, pas tij llogaria me peshën më të madhe është “Mallara dhe shërbime të tjera” rreth 18% dhe në vijim “Sigurime” me rreth 7%, dhe “Shpenzimet kapitale” zënë një peshë mjaft të vogël në vetëm nga 3%.

Gjatë vitit 2022, (sa është trajtuar dhe në relacionin e Raportit të Monitorimit të 8 mujorit) për të përmbushur nevojat e punës të Sektorit të Ekspertizës në laboratorin e Prokurorisë së Posaçme, me objekt të punës së tij ekzaminimin kriminalistik të pajisjeve dixhitale (elektronike) që sekuestrohen në kuadër të procedimeve penale dhe hetimit të veprimtarisë kriminale, si dhe në

vijim për të përmushur nevojat për shpenzime për paga, Prokuria e Posaçme, ka kërkuar rishpërndarje të fondeve nga zëri “shpenzime për sigurime” për tu kaluar në zërin “shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera” dhe në zërin për dhpenzime për paga në shumën 52 milion lekë.

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve faktike të buxhetit 2022 mbi totalin e realizimit, paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:

**Grafiku 2: Pesha sipas llogarive ekonomike e realizimit faktik të buxhetit 2022**



*Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2022);*

Për vitin 2022, rezulton se rreth 73% janë shpenzime për paga dhe pjesa tjetër nga 17% zënë shpenzimet për për mallra dhe shërbime, 7% sigurime dhe më pak rreth 3% shpenzime për Investime. Përsa i përket realizimit faktik, rezulton se në peshën e llogarive ekonomike ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara, evidentohet një ruajtje të peshës së këtyre shpenzimeve si në buxhetin e planifikuar ashtu edhe në atë të realizuar për vitin 2022. Qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të institucionit.

Nëse do të vendosim në analizë treguesit e realizuar për vitin 2022 krahasuar me realizimin për vitin 2021, të cilët paraqiten sipas tabelës së poshtëshënuar:

**Tabela 3 Realizimi Faktik në vitin 2021 dhe vitin 2022**

000/lekë

Llog. Ekonomike	Emertimi	2021 Fakti	2022 Fakti	

		12-mujor	12-mujor	Diferenca (viti 2022-20210
600	Paga	237,038.00	429,825.6	192,788
601	Sigurime Shoqërore	22,215.00	38,006.2	15,791
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	40,056.00	99,042.2	58,986
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	219	1,838.9	1,620
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>299,528.00</b>	<b>568,712.90</b>	269,185
230	Kapitale të Patrupëzuara			-
231	Kapitale të Trupëzuara	26,230.00	19,350.4	- 6,880
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>26,230.00</b>	<b>19,350.4</b>	- 6,880
<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>				-
<b>Totali (korrente + kapitale )</b>		<b>325,758.00</b>	<b>588,063.30</b>	262,305

*Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2022);*

Konstatohet se treguesit e realizimit të buxhetit të SPAK kanë një rritje si në terma real ashtu edhe në raport me totalin e shpenzimeve. Gjatë vitit 2022 buxheti i SPAK është realizuar rreth 588 milion lekë, me një rritje 262 milion lekë krahasuar me vitin paraardhës (realizuar për vitin 2021 rreth 325.7 milion lekë). Rritja vjen për shkak të shtimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të cilat janë drejt konsolidimit të plotë dhe shtimit në numër dhe të përmirësimit të treguesve të hetimeve procedurale. Në vazhdim do vijohet të synohet konsolidimi financiar dhe administrativ i institucionit me qëllim arritjen plotësisht të realizimit buxhetor dhe treguesve të performancës. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 e në vijim do të synohet përdorimi me eficiencë dhe efektivitet maksimal të burimeve financiare në raport me rritjen e nivelit të performancës së treguesve të zbatimit të ligjit të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

### 3. Analiza sipas llogarive ekonomike për vitin 2022

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2022, krahasuar me planin vjetor në programin buxhetor “Veprimtaria e SPAK”, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

**Tabela 4: Diferenca Plan/Fakt shpenzimeve të programit sipas llogarive ekonomike.**

*Ne mijë lekë*

Art.	Emertimi	1 Buxheti Vjetor Viti 2022	2 Fakti 12- mujor	3=(1-2) Diferenca	Realizimi plan/fakt
600	Paga	474,081.0	429,825.6	44,255.4	91%
601	Sigurime Shoqërore	44,985.0	38,006.2	6,978.8	84%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	121,305.0	99,042.2	22,262.8	82%

606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,928.9	1,838.9	90.0	95%
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>642,299.9</b>	<b>568,712.9</b>	73,587.0	89%
230	Kapitale të Patrupëzuara			0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara	21,000.0	19,350.4	1,649.6	92%
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>21,000.0</b>	<b>19,350.4</b>	<b>1,649.6</b>	<b>92%</b>
<b>Shpenzime Korente +Shpenzime kapitale</b>		<b>663,299.9</b>	<b>588,063.3</b>	<b>75,236.6</b>	<b>89%</b>

*Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2022);*

### 3.1 Shpenzimet e personelit

Plani i fondeve të akorduara përmes ligjit vjetor të buxhetit 2022, në zërin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është në vlerën e rreth 880.6 milion lekë ose e thënë ndryshe rreth 84.5% e totalit të buxhetit të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Ndërkohë gjatë vitit 2022 përmes Akteve Normative:

Nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 115/2021“Për buxhetin e vitit 2022”

Nr. 12, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 115/2021“Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, dhe

Nr 17, datë 01.12.2022 “Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 115/2021“Për buxhetin e vitit 2022, i ndryshuar”,

janë reflektuar pakësime në buxhetin e miratuar për programin 03390 “Veprimtaria e SPAK” duke arritur në total në vlerën e 663 milion lekë, nga të cilat shpenzime për paga dhe sigurime në shumën 519 milion lekë rreth 78% të buxhetit të rishikuar.

Nga ana tjetër në raport me planin buxhetor shpenzimet për paga dhe sigurime janë realizuar në vlerën e rreth 467.8 milion lekë ose rreth 89.6% e planit të rishikuar të miratuar për këtë natyrë të shpenzimeve. Sa trajtuar dhe më lartë gjatë vitit buxhetor, përmes akteve normative ka patur ndryshime në buxhetin e SPAK, duke rishikuar në zbritje të shpenzimeve të përealizuara dhe të vlerësuara si të panevojshme për vitin 2022 në funksion të përmbushjes së objektivave vjetore të plotësimit si të stafit administrativ ashtu edhe të personelit të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në kushtet kur SPAK është një institucion i krijuar rishtazi në fund të vitit 2019, procesi i formimit si në kuadrin e aktiviteteve dhe gjithashtu të punonjësve është shtrirë në kohë përgjatë gjithë viteve nga 2020 e në vazhdim.

**Tabela 5. Realizimi i shpenzimeve per paga për vitin 2022 (SPAK)**

Art.	Emertimi	-1	-2	(3) = (2)-(1)	(4) = (2) / (1)
		Buxheti 2022 (I rishikuar)	Fakti viti 2022	Diferenca	% e realizimit Plan/Fakt
1	Prokuroria e Posaçme	218,070	202,959	-15,111.00	93.07%
2	Byroja Kombetare e Hetimit	256,010	226,866	-29,144.00	88.62%
	SHUMA	474,080	429,825	-44,255	90.67%

*Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2022);*

Në zbatim të përcaktimeve ligjore, të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, procesi i rekrutimit të punonjësve hetimorë dhe administrativë pranë SPAK ka një procedurë specifike dhe mjaft të detajuar ligjore që synon përzgjedhjen e personave nën një set kriteresh për respektimin e integritetit të institucionit. Si rrjedhojë e këtyre procesve që kanë zgjatur në kohë për plotësimin e kërkesave ligjore gjatë vitit 2022 kanë mbetur pa plotësuar pozicioni për 3 prokurorë, Oficerët e Policisë Gjyqësore në BKH por gjithashtu edhe personel administrativ, shpenzimet e kësaj natyre ekonomike kanë rezultuar me këtë nivel mosrealizimi. Ky proces është planifikuar të përmbushet gjatë vitit 2023, duke u kompletuar me të gjitha kapacitetet e nevojshme njerezore e teknike në funksion të objektivave në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

### 3.2 Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera

Aktiviteti operacional dhe hetimor i SPAK gjatë vitit buxhetor 2022 është mbështetur nga buxheti i shtetit në llogarinë e mallrave dhe shërbimeve (Llogaria ekonomike 602) në vlerën e buxhetit të rishikuar prej rreth 121 milion lekë. Gjatë vitit 2022, institucioni nga kjo llogari ka realizuar rreth 99 milion lekë ose ndryshe 81.6% të planit të rishikuar vjetor me një rritje rreth 58.6 milion lekë më shumë se viti 2021 (gjatë vitit 2021, institucioni nga kjo llogari ka realizuar rreth 40,056 mijë lekë).

Ashtu siç mund të konstatohet në tabelën dhe përcaktimin e mësipërm, ky nivel i shpenzimeve për mallra dhe shërbime të realizuara për vitin 2022 ka ardhur për shkak se institucioni ka operuar në kushtet e shtesës së stafit administrativ dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Pas plotësimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit të gjysmën e dytë të vitit 2022 dhe gjithashtu rritjes së volumit të procedurave hetimore të zhvilluara edhe kërkesa për mallra dhe shërbime është rritur. Përmes

përdorimit me eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike SPAK ka përmbushur plotësisht të gjitha nevojat në shpenzime operationale për të mbuluar aktivitetin.

Shtimi progresiv i dosjeve që trajtohen aktualisht nga Prokuroria e Posaçme por gjithashtu edhe të çështjeve në hetim nga personeli Hetimor i Byrosë Kombëtare të Hetimit, krahasuar me vitin 2021 ka rritur ndjeshëm nivelin e konsumit të brendshëm në formën e kancelarive, shpenzimeve telefonike, veprimtarinë operative të oficerëve hetimorë në terren etj. Për vitin 2022 është bërë rishikim i regjistrit të prokurimeve lidhur me shpenzimet për karburant, kancelari, tonera, letër etj, në një vlerë të shtuar afërsisht 20 milion lekë mbi fondin e planifikuar për shkak të rritjes së ndjeshme të çmimeve që kanë rezultuar gjatë fazës së studimit të tregut.

Rritja progresive e dosjeve penale në shqyrtim, ka rritur ndjeshëm dhe shpenzimet që lidhen me përgatitjen e dosjes penale të tilla si avokatë kryesisht, përkthyes për çështje ndërkombëtare, ekspertë të tjerë të natyrave të ndryshme të tilla kriminalistë, kontabilistë, vlerësues pasurie etj, kanë rritur nevojën për shtesën e fondeve në këtë llogari ekonomike. Këto shpenzime të kësaj natyre, në fund të procesit gjyqësor i bashkëlidhen si shpenzime procedurale të cilat duhet të paguhen nga humbësi, për vitin 2022 këto shpenzime llogariten rreth 9.5 milion lekë.

Mirëmbajtja e sistemeve të Bërthamës Komanduese Elektronike, për të cilën në Qershor 2022 është lidhur kontrat shërbimi mirëmbajtje me afat 24 muaj, për vlerën 60 milion lekë nga të cilat për vitin 2022, angazhimi ka qënë në shumën 15 milion lekë, Sistemit IT për të cilën është lidhur kontrat shërbimi me afat 24 muaj në vlerën 41.4 milion lekë, nga të cilat angazhimi për vitin 2022 ka qënë rreth 1.7 milion lekë, gjithashtu për Sektorin të Ekspertizës Laboratorike në vitin 2022 janë angazhuar fonde rreth 18.1 milion lekë. Për vitet në vijim 2023-2025 referuar parashikimeve për vitin 2022 dhe kërkesave të shtuara (rrjedhojë e shtimit të kapaciteteve të sistemeve IT) parashikohet rritje e shpenzimeve të mirëmbajtjes së këtyre sistemeve. Këto shpenzime zënë rreth 58% të totalit të shpenzimeve operative të SPAK duke u rritur progresivisht edhe në periudhën e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

### 3.3 Transferta për buxhete familjare

Gjatë vitit buxhetor 2022, për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është planifikuar si Fond i Veçantë (Llogaria 606) për mbulimin e rasteve të

fatkeqësive si dhe bazuar VKM-në nr 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëherëshme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”. Për vitin 2022 fondi i përdorur është në vlerën rreth 1.8 milion lekë.

### 3.4 Shpenzime për Investime Kapitale

Në mbështetje të përcaktimeve të ligjit nr 115/2021“Për buxhetin e vitit 2022”, është planifikuar për të realizuar në formën e investimeve pranë SPAK vlera prej 30 milion lekë me qëllim mbulimin e shpenzimeve të nevojshme në formën e investimeve, në vijim me aktin normativ nr 17/2022 “Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 115/2021“Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar, është reflektuar pakësimi i fondit për investime në vlerën 9 milion lekë.

Fondi i realizuar gjatë vitit 2022 është në vlerën e rreth 19.3 milion lekë ose ndryshe rreth 92% e totalit të fondit të planifikuar të rishikuar. Gjithashtu, në formën e grantit në kapitullin 06 Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të organizuar nga fondi i përfituar, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ( në vitin 2021 për vlerën 30.2 milion lekë), për projektin për pajisjen e laboratorit të ekspertizës teknologjike, është mundësuar paisja me teknologjinë e fjalës së fundit të laboratorit. Për plotësimin e laboratorit gjatë vitit 2021 nga ky projekt është realizuar shuma prej rreth 23 milion lekë ose 76.1% të fondit të planifikuar dhe për vitin 2022 rreth 5.1 milion lekë nga fondi i mbetur pa realizuar në vitin 2021.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm sipas zërave është realizuar si më poshtë;

• Blerje pajisje zyre	3.5 milion lekë
• Shpenzime pajisje elektronike	15.8 milion lekë
<b>TOTALI</b>	<b>19.3milion lekë</b>

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka përdorur planin e shpenzimeve kapitale në funksion të përmbushjes së nevojave në zgjerim paisje zyre për punonjësit hetimorë dhe administrative dhe pajisje elektronike. Këto nevoja janë plotësuar gjatë vitit 2022 duke i vendosur në funksion të plotë të objektivave procedurale të institucionit në

hetimin aktiv të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Të gjitha shpenzimet buxhetore të realizuara për furnizimin me mallra dhe shërbime e paisje kapitale nga SPAK janë realizuar rreth 54 procedura prokurimi, mbështetur mbi të gjitha përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procedurat e prokurimit në Republikën e Shqipërisë.

### 3.5 Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, gjatë vitit 2022 nuk ka krijuar të ardhura jashtë limiti dhe si rrjedhim të gjitha efektet financiare janë mbuluar brenda buxhetit vjetor të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit.

### 3.6 Detyrimet e prapambetura

Gjatë vitit 2022, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka marrë masat që të gjitha marrëveshjet kontraktuale për investime, mallra dhe shërbime të përmbushen në përputhje me afatet kohore dhe të likuidohen në përputhje me rregullat e menaxhimit financiar publik të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Realizimi i produkteve buxhetore në nivel performance për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022 paraqiten si më poshtë:

**Tabela 6: Raporti I realizimit të objektivave të plotikës së programit**

<b>Treguesit e performancës/Produktet:</b>					
<b>Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit</b>	<b>Niveli faktik i vitit 2021</b>	<b>Niveli i planifikuar ne vitin 2022</b>	<b>Niveli i rishikuar ne vitin 2022</b>	<b>Niveli faktik viti 2022</b>	<b>% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit</b>
Raporti midis numrit të çështjeve të përfunduara kundrejt atyre të regjistruara. (196/643)	<b>41%</b>	<b>50%</b>	<b>50%</b>	<b>30%</b>	<b>61%</b>

Raporti midis numrit të çështjeve të dërguara për gjykim kundrejt atyre të përfunduara.(57/196)	<b>66%</b>	<b>70%</b>	<b>70%</b>	<b>29%</b>	41%
Raporti midis numrit të personave të gjykuar kundrejt atyre të regjistruar.(344 persona të pandehur/602 persona në hetim)	<b>96%</b>	<b>96%</b>	<b>96%</b>	<b>57%</b>	59%

*Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, SPAK (2022);*

Për sa konstatohet më lart në tabelën e paraqitur produktet buxhetore të planifikuara në programin “Veprimtaria e SPAK” kanë një nivel realizimi të kënaqshëm në raport me mesataren e planifikuar në fillim të vitit, duke marrë në konsideratë kushtet e argumenteve si më poshtë vijon:

- SPAK është një institucion i krijuar në vitin 2020 dhe si rrjedhim ka operuar në kushtet e mungesës së kapacitetit për formimin e plotë të strukturave;
- Si rrjedhojë e procedurave specifike të rekrutimit Byroja Kombëtare e Hetimit, e cila ka si objekt përmbushjen e plotë të këtyre treguesve të performancës, është vendosur në funksion të plotë në 6 mujorin e dytë të vitit 2022,

Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në vazhdim të treguesve të realizuar gjatë vitit buxhetor 2022, ka marrë një angazhim që gjatë vitit 2023 e në vazhdim të realizojë plotësisht të gjithë treguesit e performancës së përcaktuar. Ky rezultat do të arrihet përmes zbatimit të plotë të metodologjive që rregullojnë Menaxhimin Financiar Publik mbi bazë performance të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.